KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, SHGM, duke vepruar në bazë të parashtresës së Natasha Gaber-Damjanovska, Drejtoreshë e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik, kundër gazetarit **Kristijan Landov** nga **„МАКFАКS„ nga data 26.07.2023 година**, në seancën e Këshillit solli këtë

VENDIM

REFUZOHET PARASHTRESA NGA AKADEMIA PËR GJYKATËS KUNDËR GAZETARIT KRISTIJAN LANDOV PASIQË NUK KA SHKELJE TË DISPOZITAVE TË KODIT ETIK TË GAZETARËVE

A R S Y E T I M

Drejtoresha e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publikë "Pavel Shatev", Natasha Gaber Damjanovska, më datë 26.07.2023, ka dorëzuar parashtresë deri te Këshilli i Nderit dhe SHGM, duke u ankuar për sjelljen e gazetarit Kristian Landov nga "Makfax", për komunikim të ndërsjellë gjatë marrjes së informacioneve të cilat i ka kërkuar gazetari nga institucioni.

Krahas parashtresës, Akademia ka dorëzuar një transkript të komunikimit të plotë elektronik me gazetarin.

Pas shqyrtimit të materialeve, Këshilli i Nderit konstatoi se nuk është kompetent të veprojë në lëndët ku nuk është publikuar material gazetaresk, tekst, storie gazetareske, që është rast në këtë lëndë, ku deri në ditën e marrjes së vendimit në bazë të parashtresës. Gazetari nuk kishte publikuar tekst, i cili do të shqyrtohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Etikës.

Gazetari, i cili ka kërkuar dhe ka marrë informacion të caktuar nga Akademia e Gjykatësve, në pyetjet shtesë i është kërkuar që të parashtrojë kërkesë për marrjen e informacionit sipas Ligjit për qasje të lirë te informatat me karakter publik, gjë që nuk ishte e pranueshme për gazetarin.

Këshilli i Nderit nuk është rregullator i cili mund të udhëzojë cilindo gazetar se çfarë të publikojë dhe në cilën mënyre, ndërsa atë që publikohet do ta vlerësojë në përputhje me dispozitat e Kodit.

Këshilli i Nderit i bën me dije Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe drejtoreshës Natasha Gaber Damjanovska se kanë bërë shkelje të konsiderueshme të konfidencialitetit të komunikimeve, me atë që kanë dorëzuar deri te SHGM dhe Këshilli i Nderit komunikimin e plotë në internet- kërkesën për marrjen e informacioneve, e cila duhet të mbrohet mes dy palëve, në mënyrë që të mos dëmtohet storja në të cilën gazetari po punon për momentin, dhe me këtë të cënohet pavarësia gazetareske dhe politika redaktuese.

Me këtë **NJOFTIM PUBLIK,** presim që Akademia e Gjykatësve të ndërpresë këtë praktikë dhe në të njëjtën kohë ti përmbahet normave ligjore dhe të vlerësojë nëse informacionin e kërkuar do ta japë verbalisht (në brifing, me telefon), me email apo në formë tjetër elektronike ose do të zbatojë Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik.

Megjithatë, aplikanti duhet të informohet që në fillim për mënyrën e marrjes së informacionit, në mënyrë që të mos ndodhë si në këtë rast, pas disa informacioneve të marra me e-mail, që Akademia të kërkojë që informacionet shtesë të jenë sipas Ligjit për qasje të lirë te informatat me karakter publik.

Gazetarët, si dhe të gjithë kërkuesit e informacioneve janë të barabartë para Ligjit dhe Akademia duhet vetëm ta zbatojë ligjin në mënyrë konsistente. Palës jo të kënaqur i qëndrojnë në dispozicion mekanizmat për ankesë.

Çdo veprim tjetër do të hynte në sferën e censurës, e cila është e ndaluar.

-Të dorëzohet deri te:

- Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik,

- Të publikohet në faqen e SHGM-së

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM-SË

Kryetar

Sashe Dimovski